



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

BULETINI

Qershor, 2008 Nr. 19

**INFORMATA PËR PUNËN 100 - DITËSHE TË QEVERISË
DHE PRAGRAMI I SAJ PËR PERIUHDHËN 2008 – 2011**

Kosova është atdhe i gjithë qytetarëve



• Republika e Kosovës është nisur në rrugën e gjatë të rimëkëmbjes së përgjithshme . Kështu, me vlerat tona dhe fuqinë tonë ekonomike e shpirtërore, me identitetin tonë të veçantë, do të takohemi me botën, me fqinjët tanë të afërm e të largët, me kontinentin tonë, me botën

• Programi synon t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të qytetarëve tanë, përmes një politike të përgjegjshme dhe transparente që do ta shpjerë Kosovën drejt një rritjeje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e një ambienti të qetë, të sigurt për të gjithë qytetarët e saj Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social ofrohet si prioritet i përhershëm dhe afatgjatë

Mbështetje Qeverisë së Kosovës për sundimin e ligjit në tërë territorin e vendit

Njohja ndërkombëtare e Kosovës do të
vazhdojë edhe më tutje nga ana e shteteve
të BE-së dhe shtetet e tjera të botës



Proceset aktuale politike në Kosovë, çështjet e bashkëpunimit të mëtejshme të Kosovës me Zyrën Civile Ndërkombëtare në Kosovë, si dhe vizita e delegacionit të Kosovës në krye me Jakup Krasniqin në Parlamentin Evropian në Bruksel, ishin tema thelbësore të takimit të sotëm të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, me përfaqësuesin e Zyrës Civile Ndërkombëtare në Kosovë, z. Pieter Feith. Në këtë vështrim z. Pieter Feith e përgëzoi kryeparlamentarin për këtë vizitë mjaft të suksesshme, gjatë së cilës pos aktiviteteve tjera, delegacioni parlamentar i Kosovës ka mbajtur një takim me parlamentarë të vendeve të Bashkimit Evropian

dhe të Ballkanit Perëndimor, si dhe një takim me Parlamentin Evropian. Ndërkaq, në vijim z. Pieter Feith theksoi se njohja ndërkombëtare e Kosovës do të vazhdojë edhe më tutje nga ana e shteteve të BE-së dhe shtetet e tjera të botës.

Në vijim z. Pieter Feith tha se është i impresionuar me punën që ka bërë Kuvendi i Kosovës, nën udhëheqjen e kryeparlamentarit Krasniqi, sidomos me aprovimin e Kushtetutës së Kosovës, si dhe të ligjeve. Ai tha se do të mbështesim Qeverinë e Kosovës për sundimin e ligjit në tërë territorin e Kosovës. Në këtë aspekt edhe Zyra Civile Ndërkombëtare në Kosovë do të ushtrojë funksionin e vet në mbarë territorin e Kosovës.



**Kosova e ka bërë vendin
e vet në hartën politike
të botës.....3**

**Kosova është atdhe
i gjithë qytetarëve.....8**

**Pikësypnim i Sllovenisë
është stabilizimi i Ballkanit
Perëndimor dhe integrimi
i tij në BE.....13**

**Kuvendi i Kosovës është
i mirëpritur në takimet e
Asamblesë Parlamentare
të NATO-s.....14**

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi,
Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat kontaktues:

038 / 211 186 / 211 949;
038 / 211 189; 044 / 127 921

Tel/Fax: 038 211 188

E-mail: media@assembly-kosova.org
Web faqja: www.assembly-kosova.org

FJALIMI VJETOR I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
FATMIR SEJDIU PARA KUVENDIT TË KOSOVËS

Kosova e ka bërë vendin e vet në hartën politike të botës

Republika e Kosovës është nisur në rrugën e gjatë të rimëkëmbjes së përgjithshme . Kështu, me vlerat tona dhe fuqinë tonë ekonomike e shpirtërore, me identitetin tonë të veçantë, do të takohemi me botën, me fqinjët tanë të afërm e të largët, me kontinentin tonë, me botën. Ushqyer me vlerat e lirisë, të demokracisë e të pavarësisë, të respektit për të veçantat e secilit dhe për diversitetet në mes kombesh, ne, populli dhe institucionet e Kosovës, u ofrojmë përqafimin atyre që ushqehen me këto vlera



Në seancën e 18 prillit të Kuvendit të Kosovës , presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, mbajti fjalimin vjetor.Me këtë rast ai tha:” Jam paraqitur para këtij institucioni të lartë disa herë gjatë këtyre dy vjetëve si President i Kosovës dhe udhëheqës i Ekipit të Unitetit, i ngarkuar me punën e finalizimit të procesit për përcaktim të statusit, që duhej të përfundonte,

siç u krye, me pavarësimin përfundimtar të Kosovës.

Kam nderin e veçantë që sot t’i drejtohem Kuvendit dhe, përmes këtij forumi të lartë, juve qytetarë të dashur të Kosovës, me një fjalë për gjendjen e përgjithshme në vend dhe për synimet strategjike të vendit tonë, sidomos për çështje që lidhen me fushëveprimtarinë e Presidentit.

Integrimi ynë në strukturat euroatlantike është prioritet mbi të gjithë të tjerët

17 shkurti i 2008-shit do të hyjë në historinë e Kosovës e të botës si dita e pavarësisë së vendit tonë. Tash, dy muaj pas, mbasi që kemi kryer punët që lidhen me institucionalizimin ligjor të pavarësisë, në radhë të parë me miratimin e Kushtetutës së Republikës në fillim të këtij muaji, mund të themi

se Kosova është shtet që ka lindur mbarë. Republikën e Kosovës e shpallëm pas një procesi të gjatë ndërkombëtar për përcaktimin e statusit, në pajtim me vullnetin e shumicës së popullit të Kosovës, në përputhje me rekomandimet e Emisarit Ndërkombëtar të Statusit, Presidentit Marti Ahtisari, në koordinim me miqtë dhe aleatët e Kosovës, në radhë të parë me Unionin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Republika e Kosovës është përqa-

fuar gjerësisht nga bota demokratike. Pavarësia jonë është njohur nga 37 vende, duke përfshirë edhe 7 nga 8 vendet e G 8-shit. Vendi ynë pret njohje nga shumë vende të tjera. Kjo siguron bazën e rëndësishme për të mbështetur inkuadrimit tonë në sistemin ndërkombëtar. Integrimi ynë në strukturat euroatlantike është prioritet mbi të gjithë të tjerët. Për të hyrë në BE dhe në NATO na duhet njohja e të gjitha vendeve anëtare të këtyre institu-

cioneve dhe plotësimi i kriterëve për anëtarësim në të dyja organizatat. Kjo merr kohë, por është pikë synimi me rëndësinë jetike për ekzistencën tonë.

Shfrytëzojmë rastin që në emrin e shtetit të Kosovës t'u shprehim mirënjohjen më të tellë të gjithë atyre që derdhën gjak e djersë e dije për pavarësinë e Kosovës. Një nderim të veçantë meritojnë të gjitha legjislaturat dhe qeveritë e Kosovës të këtyre 18 vjetëve, organizimet politike e strukturimet vetanake shtetërore brenda vendit tonë, si dhe diaspora jonë e madhe, që kanë punuar me zell e këmbëngulje të pashembullt, por edhe sistem e disiplinë shembullore për shtetin tonë.

Ju, deputetë të legjislaturës aktuale, sikur edhe ne, udhëheqësit më të lartë të vendit, kemi pasur fatin historik të firmosim pavarësinë e Kosovës, të krijuar dhe të ndërtuar nga dhjetëra mijëra, qindra-mijëra njerëz të mirë të Kosovës, heronj të kënduar e të pakënduar, shqiptarë dhe pjesëtarë të komuniteteve pakicë. Republika e Kosovës është atdheu ynë: i të gjithëve pa dallim.

Pasuritë natyrore dhe popullsia e re janë potenciale të zhvillimit të Kosovës në afat të gjatë
Kosova e ka bërë vendin e vet në hartën politike të botës dhe dëshiron të rrethohet me fqinjë miqësorë. Ne duam të kultivojmë marrëdhënie të mira e miqësore me të gjitha vendet, në radhë të parë me fqinjët tanë të parë: me Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë, me vendet e rajonit e të Evropës, ku ne bëjmë pjesë gjeografikisht e kulturalisht. Kosova është njohur në të vërtetë nga vende nga të gjitha kontinentet e botës dhe kjo na gëzon pa masë.

Me dekada, breza të tërë veprimtarësh shqiptarë punuan për ta zgjidhur çështjen e Kosovës. Ishin këto përkushtime e sakrificat të pandërprera dhe më sublime të mundshme. Personalitete të shumta përgjatë dekadave u pushkatuan apo vuajtën në burgje të rënda dhe afatgjata.

Projekti i pavarësisë së Kosovës si zgjidhje për çështjen e Kosovës u matua në 18 vjetët e shkuara, para se të kurorëzohej me Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008. Ideja është e para, thoshte Platoni, filozofi i shtetit ideal.

Ideja e shtetit të pavarur të Kosovës ka lindur, është kultivuar dhe është ndërtuar gjatë rezistencës së përgjithshme politike e institucionale të udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova në dekadën e fundit të shekullit të kaluar. Komplementare me këtë ide, pjesë e saj dhe e luftës politike ka

qenë lufta e armatosur e UÇK-së në fund të shekullit, që lidhet me komandantin Adem Jashari e shumë luftëtarë të lirisë anekënd Kosovës. Nëntë vjetët e rezistencës politiko-ushtarake (1990-1999) dhe nëntë vjetët e rimëkëmbjes fillestare të vendit tonë në rrethana të lirisë (1999-2008) kanë krijuar Republikën e Kosovës që e kemi sot. Në pranverën e vitit 1999, aleanca veriatlantike NATO, lidhja më e fuqishme politiko-ushtarake në historinë e njerëzimit, u vu në mbrojtje të vlerave humane - kundër barbarisë dhe përpjekjes për shfarosje të popullit të Kosovës. Populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës për këtë ndërhyrje që i dha fund barbarisë dhe solli paqen në vendin tonë dhe në rajon. Kjo ishte luftë në shërbim të paqes. Kjo ishte një luftë për lirinë njerëzore si vlerë fundamentale, por edhe për shpëtimin e një populli të tërë.

Tash, që jemi shtet i pavarur dhe sovran, kemi mundësinë ta drejtojmë Kosovën në rrugën e zhvillimit strategjik, që ka qenë i vështirë, nëse jo i pamundshëm, në gjendjen e statusit të papërcaktuar. Pasuritë natyrore dhe popullsia e re janë potenciale të zhvillimit të Kosovës në afat të gjatë. Zhvillimi i plotë i tyre bëhet i mundshëm tash që kemi një Qeveri sovranë, jo të përkohshme. Me Qeveri të përkohshme, me idenë e përkohësisë e të gjendjes pezull, nuk ka zhvillim të njëmendtë ekonomik e shoqëror. Këtë e vërteton historia jonë e dekadës së fundit, e rimëkëmbjes fillestare nga shkretimi fizik e shpirtëror që kishte sjellë okupimi dhe mizoria e agresionit të Serbisë. Rimëkëmbja e plotë, rilindja e vërtetë e Kosovës mundet dhe duhet të ndodhë duke vënë në lëvizje potencialet njerëzore, duke ndërtuar institucione demokratike e plotësisht funksionale, duke ndërtuar ekonomi dhe rrjet arsimor e shëndetësor të qëndrueshëm. Vlerësoj se për prosperitetin e vendit tonë shkalla prej 3-4% e rritjes ekonomike për vit, siç mendohet se është aktualisht, është e pamjaftueshme. Na duhet dyfishimi i kësaj shkalle të rritjes në vitet e ardhshme. Shpresoj se Konferenca ndërkombëtare e Donatorëve për Kosovën, që do të mbahet pas disa muajsh, do të japë impulsin e parë për vitin e ardhshëm dhe tutje. Kapacitetet e Qeverisë sonë, e institucioneve qendore dhe lokale të pushtetit, janë me rëndësi kapitale për optimalizimin e donacioneve që do të zotohen e jepen, duke i vënë në funksion të projekteve prioritare ekonomike e infrastrukturë. Fushat strategjike ekonomike që kërkojnë vëmendjen dhe përkush-

timin prioritar të shtetit tonë janë energjetika dhe agrikultura. E para kërkon investime të mëdha, por nuk siguron punësim të madh; e dyta investim të konsiderueshëm për punësim të konsiderueshëm dhe ruajtje të balancit jetësor e social. Energjia siguron bazën për qëndrueshmëri ekonomike dhe sociale të vendit, ndërsa agrikultura komplementaritetin e zhvillimit ekonomik, që është neglizhuar në kohët e fundit. Kjo nuk do të thotë të lihen anash fushëveprimtaritë e tjera, që janë në interesin jetik për qytetarët e Kosovës.

Regjistrimi i pritshëm i popullsisë dhe i ekonomive familjare të Kosovës do të sigurojë pasqyrë të plotë statistikore, kuantitative dhe kualitative, për drejtimet strategjike që duhet të marrë zhvillimi i Republikës së Kosovës.

Duke pasur një popullsi të re, rimëkëmbja e sistemit arsimor bëhet për ne çështje me rëndësi thelbësore, që prek indin më të shëndoshë të qenies sonë. Shoqëri më të zhvilluara se, ndonëse me burime më pak të pasura natyrore, kanë dalë prej stagnimit në prosperitet duke vënë në jetë masa gjithëpërfshirëse për arsimin, duke kthyer shkollimin cilësor në të gjitha nivelet në orientim strategjik nacional. Investimi këtu është afatgjatë. Ngjashëm edhe për sistemin shëndetësor, shumë i kushtueshëm sot kudo në botë.

Është koha që të vihet rend në arsimin e lartë

Punonjësit e arsimit dhe të shëndetësisë të Kosovës duhet të nxirren prej kategorisë së shërbyesve civilë, ku bien aktualisht, për të krijuar mundësinë e diversifikimit dhe të konkurrencës së shërbimeve në rrethana të ekonomisë së tregut. Këtu, gjithësesi, roli i shtetit është i pazëvendësueshëm

si garantues dhe rregullator i sistemit, por assesi si frenues i iniciativës së lirë dhe kreative në emër të egalitetit që parasupozon për shumëkë nocioni i pjesëtarit të shërbimit civil, një nocion rudimentar sot për sot në vendin tonë. Është koha që të vihet rend në arsimin e lartë, duke aplikuar kritere të pranuar ndërkombëtare për akreditimin e institucioneve. Universitetet nuk guxojnë të shndërrohen në biznese fitimprurëse. Ato duhet të gjenerojnë dije, jo para. Duhet të synohet cilësia, duhet të stimulohet dija e kërkimi në fushat me interes nacional dhe në shkencat fundamentale, edhe kur kjo nuk duket se është kërkesë e tregut të punës. Elitat në këto fusha duhet të ndihmohen prej shtetit. Me interes të veçantë është të mbështetet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve universitare dhe shkencore të Kosovës me institucionet homologe në vendet Bashkimit Evropian dhe në SHBA.

Kultura e kërkon gjithashtu gjithë kujdesin që mund t'i japë shteti ynë. Promovimi i kulturës materiale dhe shpirtërore të vendit tonë i ndihmon krijimit të identitetit vetanak dhe të dallueshëm të Kosovës.

Shkalla gati përgjysmë më e vogël e daljes në votime në

Kosovë nuk mund të arsyetohet

Viti i kaluar dhe fillimi i këtij viti kanë shënuar përtëritjen demokratike që mundëson procesi zgjedhor. Zgjedhjet nacionale dhe lokale të nëntorit të vitit 2007 kanë sjellë rikonfigurim në skenën politike pas një procesi zgjedhor që është vlerësuar si demokratik. E meta më e madhe e këtyre zgjedhjeve pa dyshim është shkalla e daljes në zgjedhje. Kosova ka kaluar procese demokratike në

ciklet e kaluara zgjedhore, që nuk e arsyetojnë trendin në rënie të pjesëmarrjes së zgjedhësve. Nëse dy demokraci të etabluara, Franca vitin e kaluar e Italia këto ditë, shënuan pjesëmarrje të daljes në votime mbi 80%, shkalla gati përgjysmë më e vogël e daljes në votime në Kosovë nuk mund të arsyetohet. Nuk duam të besojmë se jemi ngopur me demokraci, sa të përtojmë të dalim në votime në cikle të rregullta zgjedhore.

Pavarësia e Kosovës do ta bëjë të mundshëm profilizimin politik të skenës sonë, të partive politike, si organizma të rëndësishëm të demokracisë. Opinioni kritik, por i baraspeshuar, i ditur e i përgjegjshëm, i përçarur ndër të tjera edhe nëpërmjet fuqisë së katërt pushtetore, siç konsiderohet media sot, është shumë i rëndësishëm për shëndetin e demokracisë sonë.

Kur jemi të pushtetuar - të tri pushtetuar e para, legjislativi, ekzekutivi, dhe gjyqësori - Kushtetuta jonë e sapomiruar siguron ndarje të qartë, gjë që siguron baraspeshimin e kontrolluar të sistemit pushtetor në tërësi, për të krijuar në fund të fundit një pushtet koheziv demokratik, jo autoritar. Në veçanti ky balans dhe bashkëpunim midis pushteteve duhet të sigurohet për të krijuar gamën e plotë të ligjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe kontrollin demokratik të ekzekutimit të politikave. Gjithashtu edhe për të siguruar sundimin efektiv të ligjit dhe për të ofruar siguri për të gjithë qytetarët e vendit.

Si President i vendit, që tashmë do të marrë kompetenca më thelbësore për një kryetar shteti, sidomos në fushat që janë atribut të ekzekutivit e të sovranitetit shtetëror, unë do të luaj rolin tim

me gjithë fuqitë dhe dijen time. Së pari, siç jam zotuar e më takon ta bëj, do të jem në shërbim të unitetit demokratik të popullit të Republikës së Kosovës.

Fusha klasike e sovranitetit - siguria - do të kërkojë kujdesin e të gjithëve

Në fushën e politikës së jashtme të vendit, të cilën me Kushtetutë e udhëheq unë, prioritet të parë do ta kemi sigurimin e njohjes sa më të shpejtë dhe integrimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare. Në këtë fushë, rol të veçantë do të ketë Qeveria, gjegjësisht Ministria e Jashtme, që është tani në fazën e hershme të funksionalizimit. Do të krijojmë përfaqësim diplomatik në botë në përputhje me mundësitë dhe interesat jetike të Republikës së re të Kosovës. Do të ndërtojmë edhe shërbimin konsullar jashtë, për t'u shërbyer qytetarëve të huaj dhe diasporës sonë. Ky përfaqësim diplomatik në përgjithësi do të jetë fytyra ndërkombëtare e Kosovës, shumë e rëndësishme tash e në të ardhmen për promovim të interesave të vendit tonë jashtë.

Fusha klasike e sovranitetit - siguria - për të cilën unë kam tani edhe rol kushtetues, do të kërkojë kujdesin e të gjithëve: të Presidentit e të Qeverisë në radhë të parë, por edhe të pranisë ndërkombëtare për një periudhë disavjeçare. Forca e Sigurisë e Kosovës do të ndërtohet mbi kriteret e NATO-s dhe me ndihmën e Aleancës. Ndërkohë, me kujdes e respekt do të trajtojmë TMK-në si forcë që ka luajtur rolin e vet të rëndësishëm në fushën e emergjencave civile. Do të forcohet policia e Kosovës për të marrë detyra të reja. Do të krijohet Agjencia e Inteligjencës e Kosovës. Unë këtu kam rol kushtetues, po ashtu, në

bashkëpunim me Kryeministrin e vendit, rol që do ta ushtroj për të mirën e sigurisë së shtetit dhe të gjithë shtetasve tanë. Do të krijojmë shërbim të inteligjencës mbi kritere pastërtisht profesionale, të paanshëm politikisht, besnik ndaj shtetit dhe interesave të të gjithë qytetarëve tanë.

Pavarësia jonë e mbikëqyruar në këtë periudhë mbështetet mbi premisën e një komponente të fuqishme të pranisë ndërkombëtare - misionit të EULEX-it, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, që do të ketë rol më shumë se mbikëqyrës në fusha të sigurisë e të ligjit. Ne do të bashkëpunojmë me këtë mision dhe me Përfaqësuesin Civil, prania e të cilëve në Kosovë buron nga Plani i Ahtisarit, duke u legjitimituar tutje edhe më fuqishëm nga ftesa që u kemi bërë ne, institucionet legjitime të Kosovës.

Çmujmë lart pjekurinë politike të qytetarëve të Kosovës dhe kontributin e tyre të jashtëzakonshëm për stabilitetin e vendit, punën dhe angazhimin profesional të institucioneve ndërkombëtare dhe vendëse të sigurisë, që me sukses po kapërcëjnë sfidat dhe provokimet e herëpashërme që vijnë nga kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës.

Gjyqësori i Kosovës është pushtet që pret të reformohet thellësisht në pajtim me nevojat e vendit tonë dhe standardet e fuqishme ndërkombëtare që kemi përqaftuar për këtë fushë. Koha e re kërkon njerëz të rinj, profesionistë të dijshtëm e të përkushtuar, jashtë ndikimeve politike apo tjetërfare nga jashtë. Unë si President do të luaj rolin që më takon për të siguruar bazat e kësaj reforme, për të krijuar një gjyqësor të pavarur, shtyllë të rëndësishme të shtetit ku sundon ligji, me barazi të të

gjithëve para këtij ligji.

Tash nuk ka, por do të ketë sundim të ligjit në gjithë territorin e Kosovës. Kosova do të jetë unike - territorialisht dhe funksionalisht - pavarësisht problemeve me të cilat ballafaqohemi sot nga strukturat paralele që sponsorizon Serbia në Kosovë, me qëllim që ta sfidojë rendin dhe ligjin e shtetit tonë dhe madje vetë ekzistencën e Republikës së pavarur të Kosovës. Për këtë punë kërkohet veprim i integruar i të gjithë lojtarëve - i Qeverisë së Kosovës, i Zyrës Ndërkombëtare Civile, i EULEX-it, por edhe i UNMIK-ut për kohën dhe mandatin që ka deri në tranzicionin e plotë të pushtetit tek institucionet e Kosovës.

Me dhembje të vazhdueshme e themi se ende rreth dy mijë familje nuk kanë asnjë asnjë informacion për familjarët e tyre të pagjetur. Do të angazhohemi që sa më parë të ndriçohet fati i tyre, bashkë me presionin ndërkombëtar që duhet të bëhet mbi Serbinë.

Liria e secilit është liria e të gjithëve në Kosovë

Këto ditë ekziston një fushatë e madhe dhe përpjekje e Serbisë për mbajtje të zgjedhjeve që ka paralajmëruar për 11 maj.

E kam thënë dhe po e përsëris këtu, para jush, deputetë e qytetarë të nderuar: Kosova nuk është dhe nuk mund të jetë bazë zgjedhore për krijimin e pushtetit të Serbisë në Kosovë. Kjo ka marrë fund një herë e mirë. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, i njohur ndërkombëtarisht. Me parimin e dyshtetësisë, serbët e Kosovës që duan të jenë edhe shtetas të Serbisë, mund të votojnë për pushtetin e Serbisë në Serbi. Prandaj, i thërrasim qytetarët e Kosovës të jenë akterë të rëndësishëm të jetës institucionale të

Kosovës.

Ju, përfaqësuesve dhe qytetarëve të komunitetit serb, shtetas të Kosovës, ju them atë që e kemi thënë edhe në raste të tjera ne udhëheqësit e Kosovës, udhëheqësit tuaj: Kosova është atdheu ynë i përbashkët, i të gjithëve pa dallim. Një pjesë e qytetarëve tanë e ka pasë marrë me drojë krijimin e Kosovës së pavarur, kryesisht si rezultat i indoktrinimit sistematik, të ndikimit dhe të presioneve që vijnë nga Serbia, nga elitat politike e kishtarë atje. Këta dy muajt e parë kanë dëshmuar se droja ka qenë e pavend. Në Kosovë ka vend për të gjithë qytetarët e vet. Koha jonë është kohë e barazisë qytetare, jo e dominimit të askujt mbi askënd. Duhet të çmësohemi një herë e mirë me kulturën e dominimit të kohëve të shkuara. Liria e secilit është liria e të gjithëve në Kosovë.

Për të ndërtuar një forum ku të shqyrtohen interesat e komuniteteve, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është sanksionuar funksionimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete, i cili do të funksionojë brenda Zyrës së Presidentit të Kosovës, nën kryesimin tim. Unë planifkoj që së shpejti të ndërtoj një bërthamë organizative të këtij Këshilli, ndërsa funksionalizimi i plotë i tij do të bëhet pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në shenjë respekti e kujdesi për shqetësimet legjitime që mund të kenë komunitetet, ne kemi pasë krijuar një Këshill të tillë edhe para se të sanksionohej me Kushtetutë, në kohën kur krijonim pakon e statusit me ndërmjetësimin ndërkombëtar.

Mbasi kemi realizuar projektin më të madh kombëtar që ka një popull, ndërtimin e shtetit, ne kemi përpara sprovë të mëdha, jo pak të

vështira, por të realizueshme: ta bëjmë Kosovën shtet plotësisht funksional, të qëndrueshëm politikisht dhe ekonomikisht, të sigurt për të gjithë qytetarët, pjesëtar i komunitetit më të gjerë të kombeve të lira në Evropë e në botë. Në botë ka shtete më të mëdha e më të vogla, më të pasura e më të varfëra se ne, por ka vetëm një Kosovë: vend me histori të moçme, me shtresime identitare e etnike që shkojnë përtej mileniumeve, me histori të paqes e të luftës, me një shpirt thellësisht demokratik dhe frymë të respektit e të pajtimit qytetar. Kjo është Kosova jonë, atdheu ynë, demokracia më e re në botë, shteti i 193-të që pret të hyjë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Republika e Kosovës është nisur në rrugën e gjatë të rimëkëmbjes së përgjithshme të vendit tonë. Kështu, me vlerat tona dhe fuqinë tonë ekonomike e shpirtërore, me identitetin tonë të veçantë, do të takohemi me botën, me fqinjët tanë të afërm e të largët, me kontinentin tonë, me botën. Ushqyer me vlerat e lirisë, të demokracisë e të pavarësisë, të respektit për të veçantat e secilit dhe për diversitetet në mes kombesh, ne, populli dhe institucionet e Kosovës, u ofrojmë përqaftimin atyre që ushqehen me këto vlera.

Krejt në fund, u falënderit vendeve të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sikur edhe vendeve të tjera që kanë njohur Republikën e Kosovës dhe atyre që kanë shprehur gatishmërinë ta përqafojnë shtetin e ri në familjen e kombeve të lira të botës. Një falënderim i veçantë për ndihmën e madhe që po japin institucionet e pranisë ndërkombëtare në Kosovë - UNMIK-u, EULEX-u dhe KFOR-i", theksoi Fatmir Sejdiu.

Kosova është atdhe i gjithë qytetarëve

Gjatë kësaj kohe Kosova fitoi përkrahje të jashtëzakonshme ndërkombëtare. Kosovës, de facto i është hapur perspektiva për kandidim të sigurt në NATO dhe Bashkimin Evropian. Kjo rrugë është e pandalshme dhe suksesi është i përbashkët

Programi synon t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të qytetarëve tanë, përmes një politike të përgjegjshme dhe transparente që do ta shpjerë Kosovën drejt një rritjeje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e një ambienti të qetë, të sigurt për të gjithë qytetarët e saj. Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social ofrohet si prioritet i përhershëm dhe afatgjatë



Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar që para deputetëve të Kuvendit, në seancën e 18 prillit të paraqesë Informatën lidhur me punën 100 - ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë

rast Hashim Thaçi tha se me vullnetin tim, me vullnetin dhe përgjegjësinë e gjithë ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqes informatën e plotë për punën e Qeverisë në 100 ditshin e parë.

Kjo informatë nuk është obligim kushtetues, por është vullnet imi dhe i Qeverisë së Kosovës, të institucioneve shtetërore të Kosovës që të punojmë me përgjegjësi për transparencë.

Gjatë kësaj kohe ne bashkërisht, të

gjitha institucionet e Kosovës, Kosovën e bëmë shtet të pavarur, sovran, demokratik, Kosovën shumetnike, Kosovën vend të shqiptarëve dhe të gjitha komuniteteve tjera.

Institucionet e Kosovës, të gjitha partitë politike, me vullnetin edhe të gjithë qytetarëve festuam me dinjitet, krenari dhe përgjegjësi shpalljen e Kosovës shtet. Shtetin e Kosovës, vetëm gjatë kësaj periudhe, e njohën rreth 40 shtete më të fuqishme të botës demokratike dhe procesi i njohjes është në vazhdim.

Në këtë kohë Kosova nxori edhe Kushtetutën e shtetit të vet, Kushtetutën moderne, Kushtetutën e perspektivës, Kushtetutën që i hap perspektivë të sigurt edhe zhvillimit ekonomik, edhe stabilitetit institucional, edhe sundimit të ligjit, edhe perspektivës integruese.

Gjatë kësaj kohe Kosova fitoi përkrahje të jashtëzakonshme ndërkombëtare. Kosovës, de fakto i është hapur perspektiva për kandidim të sigurt në NATO dhe Bashkimin Evropian. Kjo rrugë është e pandalshme dhe suksesi është i përbashkët.

Unë ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen, mirëkuptimin dhe besimin që na është dhënë nga të gjithë ju për punën gjatë kësaj periudhe. Natyrisht, kjo periudhë ka qenë edhe periudha e vendimeve historike, e vendimeve të përbashkët, por natyrisht edhe qasjeve të ndryshme për problemet të ndryshme qeverisëse në vend. Por e gjithë kjo, nga Qeveria e Kosovës dhe unë, është mirëkuptuar që të jetë një konkurrencë e vlerave, një konkurrencë për të mirën e vendit tonë dhe gjithë qytetarëve tonë. Prandaj, edhe për sugjerimet, vërejtjet e kritikën e kohëpaskohshme kanë qenë të mirëpritura dhe natyrisht të vlerësuara edhe nga Qeveria. Natyrisht se gjatë periudhës së

mëhershme ne kemi dhënë premtimet tona, por edhe kemi filluar implementimin si Qeveri e Kosovës, një implementim me përgjegjësi të lartë shtetërore.

Kursehen së paku 30 milionë euro

Kemi filluar se instaluar qeverisjen e mirë, stabile, efikase dhe shumë transparente. Kemi filluar implementimin e procesit të zhvillimit të arsimit, një proces ky shumë i ndërlikuar, por që vetëm në periudhën e 90-ditëshit, 100 - ditëshit ka shënuar një progres të paparë për rrethanat, kushtet dhe realitetet kosovare, gjithashtu edhe kompjuterizimi i shkollave. Kemi vazhduar me infrastrukturë rrugore, përmirësimin e gjendjes energjetike, luftën kundër korrupsionit, perspektivën perëndimore për Kosovën.

Që nga dita e parë kemi filluar t'i realizojmë objektivat. Fillimisht kemi marrë masa si Qeveri për llogaridhënie për shpenzimet e parasë publike. Vetëm me vendim për kufizimin e shpenzimeve brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës - efekti i parë, për dallim nga Qeveria e kaluar, ku ishin shpenzuar rreth 52 milion euro, ne kemi zotuar që t'i kursejmë së paku 30 milionë euro për t'i investuar në sektorë të tjerë institucional për të mirën e vendit dhe mirëqenien sociale të qytetarëve të Kosovës.

Kemi respektuar profesionalizmin e shërbyesve civilë. Përkundër rasteve të caktuara e të shumta po them, të paafësive, injorancës, pretendimit për ndonjë bllokadë të caktuar, asnjë shërbyes civil nuk është larguar nga puna dhe kjo nuk do të tolerohet edhe në të ardhmen. Ne kemi filluar që t'i nxjerrim nxënësit nga kontejnerët, të bëjmë zgjerimin dhe modernizimin e hapësirave edukative, të ndërtojmë shkolla të reja dhe t'i kompjuteri-

zojmë ato. Këto nuk janë donacione, janë punë, projekte konkrete të investuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga Ministria e Arsimit.

Kemi krijuar autonomi menaxheriale dhe financiare për Universitetin e Prishtinës. Kemi marrë vendime për digjitalizimin e të dhënave në Universitetin e Prishtinës, vendimi për ndërtimin e Fakultetit të Edukimit për çka janë ndarë edhe mjetet financiare.

Kemi filluar formësimin e vendimit për hapjen e Fakultetit të Teknologjisë Informative, tash janë duke u shqyrtuar edhe mundësitë e mbulesës financiare edhe kjo do të ndodhë së shpejti. Kemi marrë vendim për uljen e taksave për regjistrimin e studentëve për vitin e ri akademik. Kemi vazhduar ndërtimin e konvikteve. Kemi marrë vendim për uljen e çmimeve për studentë për banim dhe ushqim, por edhe rritjen e standardit të tyre, e gjithashtu edhe vendimin për akreditim për të gjitha universitetet sipas Deklaratës së Bolonjës.

Ndërtohen shumë rrugë lokale e nacionale

Kemi filluar edhe ndërtimin e shumë rrugëve lokale e nacionale. Është hapur oferta për fillimin e punimeve të auto-rrugës, Vërmicë - Prishtinë - Merdar. Gjithashtu, edhe korniza kohore është e specifikuar dhe është e njohur edhe për ju, për qytetarët, ashtu si edhe mbulesa financiare dhe natyrisht se do të fillojë në kohën dhe sipas programit, të cilën e kemi diskutuar dhe kemi marrë vendime. Natyrisht se kjo do të jetë një ofertë publike edhe vendore, por edhe ndërkombëtare. Në anën tjetër, ka filluar studimi për Auto-rrugën Prishtinë - Ferizaj - Hani i Elezit. Gjendjen energjetike e kemi gjetur në kolaps të vërtetë. Kosovën e kemi gjetur në terr të vërtetë.

Vështirësitë dhe pengesat fillestare ishin të jashtëzakonshme, por edhe këmbëngulësia jonë ka qenë e madhe dhe sot kemi ndërtuar strategjinë konkrete, e cila është përgatitur nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. U ballafaquam me mentalitetin e territ, keqmenaxhimin, keqpërdorimeve, por edhe korrupsionit. Kjo strategji e Qeverisë së Kosovës

parashikon konsolidimin e resurseve aktuale dhe rritjen e efikasitetit të menaxhmentit, investime përmes koncesioneve dhe partneritetit publik privatizues. Vendimet të cilat edhe mbrëmë janë marrë nga Qeveria e Kosovës, shkojnë në drejtim të largimit nga mentaliteti i ekonomisë së planifikimit socialist, në ekonomi të lirë të tregut në procesin e koncesioneve, në procesin e

privatizimit përmes partneritetit, por edhe privatizimit të plotë dhe fillimin e ndërtimit të termocentraleve të reja.

Kjo strategji vazhdon me objektivat për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, duke u përmbytur në mënyrë të plotë kriteret për mbrojtjen e ambientit jetësor. Gjithashtu, është formësuar edhe vendimi për kompletimin e

Ambient të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të huaja

Ky Program paraqet përkushtimin e Qeverisë në konsolidimin e institucioneve, kompletimin e legjislativës, konsolidimin e administratës publike në përputhje me standardet evropiane, si dhe vënien e rendit dhe të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Programi synon t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të qytetarëve tanë, përmes një politike të përgjegjshme dhe transparente që do ta shpjerë Kosovën drejt një rritjeje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e një ambienti të qetë, të sigurt për të gjithë qytetarët e saj. Me këtë Program, prioritetet më të shprehura janë në katër shtylla kryesore: rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social. Këto prioritetë janë rezultat i një procesi të gjatë, të konsultimit të Qeverisë brendapërbrenda, po natyrisht edhe me komunat dhe me shoqërinë civile. Synimi i Qeverisë është që

këto prioritetë të jenë të përballueshme dhe të qëndrueshme në aspektin fiskal. Kostoja e tyre do të përcaktohet me kornizën afatmesme të shpenzimeve si dhe me mundësinë e aplikimit të projekteve konkrete në Konferencën e Donatorëve për Kosovën.

Kapacitetet ekzistuese energjetike dhe infrastruktura e dobët rrugore paraqesin barrierë në zhvillim, në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, por edhe në sundimin e ligjit. Jam i bindur se potencialet e resurseve natyrore që ka Kosova dhe shfrytëzimi i tyre do ta rrisin zhvillimin ekonomik, do ta ulin shkallën e papunësisë dhe do t'i përmirësojnë kushtet sociale dhe do ta zvogëlojnë varfërinë. Programi ofron mundësinë për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të huaja, që të jemi konkurrues në vendet e regjionit. Investimet kualitative me qëllim të rritjes së produktivitetit, në veçanti në sektorin e energjetikës, infrastruktura rrugore, ngritja e cilësisë së arsimit, politikës dhe tregut adekuat financiar, sundimi i plotë i ligjit, do të jenë mundësi tjera të këtij programi

2008-2011.

Spektori i bujqësisë është i rëndësishëm dhe ka vëmendje të veçantë në këtë program, që do të mundësojë rivitalizimin e tij dhe ndikimin direkt në uljen e papunësisë. Energjia dhe minierat, furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm paraqet parakusht të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të Kosovës dhe premtim mandator të kësaj Qeverie. Në planin afatshkurtër, dalja nga kriza energjetike parashihet në tri faza, duke involvuar edhe kapitalin privat. Kosova mund të fillojë marrëveshje për koncesion ose privatizim përmes një procesi transparent, mirë të menaxhuar që do t'i sillte përfitime të shumëfishta Kosovës. Me planin afatgjatë, synimi i Qeverisë është procesi i ndërtimit të Termocentralit C, projekt ky që do të përcjellë dinamikën e vendosur me asistencë teknike nga Banka Botërore, AER-i, USAID-i dhe format tjera të avancuara të ofertimit transparent dhe konkurrues, duke marrë parasysh ndikimet sociale dhe ambientale. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet transporti hekurudhor, në të cilin parashihet in-

Komiteti Drejtues për projektin e Kosovës C, natyrisht me një shqyrtim serioz, të kujdesshëm për shëndetin e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kemi mbështetur punën profesionale të shërbyesve civilë. Pensionistët tashmë kanë prekur rezultatin e parë të premtimeve dhe përgjegjësive e vendimeve të Qeverisë së Republikës së

vestimi, përmirësimi dhe revitalizimi i infrastrukturës hekurudhore ekzistuese. Po ashtu, parashihet ndërtimi i infrastrukturës së re, investimi në zhvillimin e shërbimeve dhe të sigurisë në transportin hekurudhor.

Në fushën e aviacionit do të kemi mundësi në investim, modernizim dhe zhvillim të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Do të ketë rritje të operacioneve ajrore të navigacionit, do të bëhet aftësimi i Aeroportit të Gjakovës me mundësitë që kemi për qëllime komerciale dhe si aeroport alternativ. Dhe, po ashtu, janë duke u studiuar mundësitë më të mira që të krijohet Njësia e Helikopterëve.

Telekomunikacioni, do të reformohet me legjislacion dhe teknologji. Do të konsolidohet Operatori Publik i Telefonisë, do të rritet, zgjerohet dhe përmirësohet Shërbimi Telefonik Postar dhe ai i Internetit, përmes formave të veçanta ose të kombinuara të financimit publik dhe të atij privat.

Kosovës. Natyrisht, pritet të bëhet edhe më tepër.

Prandaj, kemi filluar sigurimin e barërave esenciale gratis, transporti publik 50% më i lirë, fillimi i ngritjes pothuaj 100% për pensionistët kontribut-dhënës. Ligji për pensionistët është në fazën finale dhe do të nxirret së shpejti e do të fillojë së implementuari.

Reforma në drejtësi, gjyqësi e pavarur funksionale

Shëndeti i qytetarëve tanë vazhdon të jetë shqetësim për Qeverinë. E ka përmendur shpesh edhe i nderuari ministri Gashi gjendjen e rëndë që e ka gjetur edhe këtë dikaster të rëndësishëm për vendin dhe qytetarët tanë. Jemi angazhuar që nga dita e parë edhe personalisht, së bashku me ministrin, që gjendja në sektorin e shëndetësisë të përmirësohet, të depolitizohet dhe të dekriminalizohet, siç e ka potencuar dhe argumentuar ministri, si dhe evitimin dhe tejkalimin e fenomeneve negative, higjienën, që të ketë higjienë të standardit më të lartë, barëra më shumë dhe më cilësore, infrastrukturë më moderne, investim në dije, përgatitje që të jemi edhe pjesë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Kemi vazhduar me reforma në drejtësi për gjyqësi të pavarur funksionale, sundim të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Do t'i vazhdojmë reformat në ekonomi dhe financa, por, gjithashtu, edhe rritje të angazhimeve në tregti dhe industri edhe vazhdimin e reformimit të pushtit lokal për të cilën kemi vendosur bashkërisht të gjitha sipas standardeve dhe Dokumentit të Presidentit Ahtisari.

VIJON NË FAQEN 18

U MIRATUA PROJEKTLIGJI PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Festave shtetërore të Kosovës i janë shtuar edhe ditët memoriale

Pas takimesh e mbledhjesh gati permanente të Komisionit ad hoc parlamentar për shqyrtimin e projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtisaarit dhe konsultimeve të vazhdueshme me presidentin Sejdiu, kryeministrin Thaçi, kryeparlamentarin Krasniqi dhe faktorët ndërkombëtarë në Kosovë, lidhur me plotësimin e kalendarit të festave, deputetët e Kuvendit, më 23 maj 2008, miratuan Ligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Ligji është pasuruar me dy amendamente, kurse festave shtetërore të Kosovës i janë shtuar edhe ditët memoriale: 28 Nëntori - dita e shqiptareve, 12 Qershori - dita e paqes, 6 Marsi - dita e Përkujtimit dhe e Respektit për Veteranet, 23 Prilli - dita e turqve, 8 Prilli - dita e romeve, 15 Shkurti - dita e ashkalinjëve, 28 Shtatori - dita e boshnjakeve dhe 6 Maji - dita e goranëve.

Ditët tjera memoriale përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim me Presidentin e Republikës Kosovës, nga të cilat dy ditë në konsultim me komunitetin serb të Kosovës – theksohet në raportin e Komisionit ad hoc, të cilin para deputetëve e ka prezantuar, Fehmi Mujota, kryetar i komisionit.

Raporti i Komisionit është miratuar me shumicë votash të deputetëve të pranishëm në seancë, siç është miratuar edhe ligji në tërësi.

Falënderim për njohjen e shpejtë që i ka bërë Belgjika shtetit të Kosovës

Të ndihmohet Kosova për t' u integruar edhe në mekanizmat evro-atlantik.-U nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi

Me ftesë të kryetarit të Parlamentit të Belgjikës, z. Herman Van Rompui, sot filloi vizitën zyrtare treditëshe në Bruksel, një delegacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilit i prin kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi. Në përbërje të delegacionit janë edhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi dhe Slobodan Petroviq. Gjatë ditës së sotme delegacioni Parlamentar i Kosovës, në krye me Jakup Krasniqin u prit nga kryetari të Parlamentit të Belgjikës, z. Herman Van Rompui. Kryeparlamentari i Krasniqi me këtë rast e falenderoi përzemërsisht z. Rompuy për mbeshtetjen që i ka dhënë Parlamenti i Belgjikës, Kuvendit të Kosovës. Ai u falenderua edhe për njohjen e shpejtë që i ka bërë Belgjika shtetit të Kosovës. Kryetari në mes të tjerave kërkoi që edhe më tej Parlamenti belg ta ndihmojë Parlamentin e Kosovës, si dhe të ndihmojë që Kosova të integrohet edhe në mekanizmat evro-atlantik.

Në vijim z. Rompuy, falenderoi z. Krasniqi për vizitën që po i bënte Parlamentit Belge, duke e siguruar kryetarin Krasniqi se se do të angazhohet që edhe më tej të ngritet niveli i bashkëpunimit ndërparlamentar. Gjithashtu ai theksoi se do të angazhohet Kosova sa më shpejtë të gjejë mundësinë që të anëtarësohet në mekanizmat evropianë.

Kryeparlamentari Krasniqi gjatë ditës së sotme takoi edhe z. Herman De Croo- nënkryetar i Dhomës së

Përfaqësuesve të Belgjikës dhe kryetar i Komisionit Federativ Këshillues për çështjet evropiane të Parlamentit Belg.

Gjatë takimit kryetari i Kuvendit u angazhua që të arrihet një Memorandum Bashkëpunimi në mes dy Parlamenteve, ndërsa z. De Croo e falenderoi për ekspozitën që bëri kryetari i Kuvendit të Kosovës për punët që janë bërë pas pavarësisë së Kosovës. Në këtë frymë z. De Croo theksoi se të gjitha vendet e ish- Jugosllavisë duhet të integrohen në Bashkimin Evropian.

Gjatë ditës së sotme kryeparlamentari Krasniqi zhvilloi edhe disa takime të tjera, siç ishte edhe takimi në Gjykatën e Auditimit.

Ditën e dytë të vizitës në Bruksel, delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i prirë nga kryeparlamentari Jakup Krasniqi, u prit në një takim kurtuazie nga kryetari i Senatit të Belgjikës, Armond de Decker. Kryetari i Senatit në fillim falenderoi kryeparlamentarin Krasniqi për këtë vizitë që i bënte Parlamentit dhe Senatit të Belgjikës. Belgjika, theksoi Armond de Decker, ka ndjekur me shumë kujdes zhvillimet në Kosovë që nga Lufta e deri më 17 shkurt, kur u shpall Pavarësia e Kosovës dhe shpejt njohu pavarësinë e Kosovës. Angazhohemi për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në mbarë Ballkanin. Belgjika është mjaft prezente me investime në Ballkan. Investitorët belg do të investojnë edhe në Kosovë,

ndaj atje duhet të ketë gjendje stabile. Kryeparlamentari Krasniqi pasi falenderoi kryetarin e Senatit për mikpritjen, bëri një paraqitje rreth zhvillimeve politike në Kosovë, si dhe për punën e Parlamentit në aprovimin e ligjeve, sidomos ato që dalin nga Pakoja e Ahtisarit. Gjithashtu, kryeparlamentari Krasniqi u falenderua edhe për njohjen e shpejtë që i ka bërë Belgjika Kosovës si shtet i pavarur. Në këtë frymë Parlamenti i Kosovës synon vendosjen e marrëdhënieve bilaterale mes dy shteteve.

Në vazhdim të këtij takimi kryeparlamentari Krasniqi theksoi se pret nga Belgjika që të ndihmojë edhe më tutje Kosovën për t' u integruar në mekanizmat evro-atlantik. Kryeparlamentari Krasniqi njohu mikpritësit edhe me infrastrukturën ligjore, e cila nxit investimet e huaja në Kosovë.

Në shenjë nderi për kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, deputeti i Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës, Patrik Morian, i cili është edhe kryetar i Grupit për Ballkanin, në Unionin Interparlamentar Evropian shtroi edhe një drekë për delegacionin nga Parlamenti i Kosovës.

Gjatë kësaj vizite ndërmjet Parlamentit të Belgjikës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi, i cili u nënshkrua nga sekretarët e këtyre parlamenteve, përkatësisht Robert Mitiner dhe Ismet Krasniqi.

Pikësytim i Sllovenisë është stabilizimi i Ballkanit Perëndimor dhe integrimi i tij në BE

Sllovenia gjithnjë do të jetë në mbështetje të Kosovës.- Çmohet lart politikën që po ndjek Kosova ndaj pakicave.-Sllovenia tashmë ka vendosur që në Prishtinë të hapë ambasadën e vet



Me ftesë të kryetarit të Parlamentit të Sllovenisë, France Cukjati, sot filloi vizitën zyrtare dyditëshe në Lubjanë një delegacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilit i prin kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi. Në përbërje të delegacionit janë edhe anëtarët e Kryesisë : Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Nexhat Daci dhe Slobodan Petroviq.

Kryeparlamentari Jakup Krasniqi bashkë me anëtarët e delegacionit, në fillim u takua me kryetarin e Kuvendit të Sllovenisë, France Cukjati. Në këtë takim u fol për thellimin e mëtejme të marrëdhënieve bilaterale politike dhe ekonomike ndërmjet Sllovenisë e Kosovës. Pikësytim i Sllovenisë tha France Cukjati është stabilizimi i Ballkanit Perëndimor dhe integrimi i tij në BE. Z. Cukjati, pasi theksoi se Sllovenia gjithnjë do të jetë në mbështetje të Kosovës, çmoi lart politikën që po ndjek Kosova ndaj pakicave. Në takim u fol edhe për çështjen e marrëdhënieve ndërfqinjësore në Rajon, përkatësisht vendosjen e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe

fqinjve, pra edhe me Serbinë.

Kryeparlamentari Krasniqi gjatë takimit foli edhe për liberalizimin e vizave për qytetarët, të cilët duan të punojnë, studiojnë, ose të merren me afarizëm me vendet evropiane. Në fund të këtij muaji do të mbahet një tubim i parlamentarëve evropianë në Bruksel, ku do të diskutohet edhe për liberalizimin e vizave. Të dy delegacionet ishin unik në mendimin se ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë duhet të forcohen edhe më tej marrëdhëniet në të gjitha fushat, si: në lëmin ndërparlamentar, në ekonomi, arsim, shëndetësi etj. Delegacioni nga Kosova shprehu kërkesën që Sllovenia edhe më tutje të vazhdojë përpjekjet drejt integritit të Kosovës në mekanizmat evropiantik, si dhe angazhimet për njohjen ndërkombëtare të Kosovës edhe nga ana e shteteve të tjera të botës.

Në vijim të takimeve me zyrtarë të lartë të Sllovenisë, sot delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilit i prin kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, u takua me ministrin

e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, Dimitrije Rupel. Gjatë këtij takimi ministri Dimitrije Rupel tha se Sllovenia ndjek me vëmendje zhvillimet në Kosovë, si mike e denjë e këtij shteti. Përpjekjet tona, theksoi Rupel, janë të përqendruara që t'ju ndihmojmë, sidomos në anëtarësimin euroatlantik, por në të njëjtën kohë angazhohemi për pjesëmarrjen e Kosovës edhe në takime të rëndësishme ndërkombëtare. Në këtë takim u bisedua edhe për Misionin e UNMIK-ut pas 15 qershorit, si dhe për qëndrimin e Kosovës ndaj pozitës së minoriteteve. Në këtë frymë, Rupel tha se shteti i ri i Kosovës konsiderohet si shtet simpatik dhe këtë imazh duhet ta ruajë. Z. Dimitrije Rupel, u shpreh se Sllovenia tashmë ka vendosur që në Prishtinë të hapë ambasadën e vet.

Kryeparlamentari Jakup Krasniqi, pasi foli për të arriturat në punën e Kuvendit të Kosovës në fushën e legjislacionit, çmoi lart ndihmën e Sllovenisë ndaj Kosovës, që e karakterizoi si vlerë të madhe. Ai kërkoi që edhe më tutje Sllovenia të mbështesë Kosovën në zhvillimet e mëtejme. Në vazhdim kryeparlamentari Krasniqi u angazhua për marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet, pra edhe me Serbinë, sidomos duke marrë para sysh fitoren e forcave proevropiane në zgjedhjet e fundit në Serbi.

Gjithë vizita e delegacionit parlamentar të Kosovës po kalon në një atmosferë shumë të ngrohtë dhe miqësore. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, ftoi në vizitë në Kosovë, kryetarin e Parlamentit të Sllovenisë France Cukjatin.

KRYEPARLAMENTARI KRASNIQI BASHKË ME ANËTARËT E KRYESISË PRITI NJË DELEGACION TË ASAMBLESË PARLAMENTARE TË NATO-S

Kuvendi i Kosovës është i mirëpritur në takimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Kushtetuta e Kosovës sublimon në vete Planin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit. - Populli dhe institucionet e Kosovës kanë për synim integrimin në mekanizmat evropianë dhe euroatlantikë

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, bashkë me anëtarët e Kryesisë ka pritur sot një delegacion njëzet e një anëtarësh të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, të kryesuar nga Michael Clapham, më të cilin ka biseduar për zhvillimet në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë së vendit, për aktivitetet e Kuvendit të Kosovës në këtë periudhë dhe në të ardhmen, për mbështetjen që ka nevojë shteti i ri i Kosovës dhe për synimet e vendit për integrimin në mekanizmat evropianë dhe euroatlantikë.

Kryeparlamentari Krasniqi duke e falënderuar Aleancën Veri-Atlantike për mbështetjen e Kosovës në momente të vështira historike, ka theksuar se populli i Kosovës u është përjetë mirënjohës forcave të NATO-s, të cilat i përjeton si çlirimtare dhe shpëtuese të popullit tonë të rrezikuar.

Nga 17 shkurti, ka thënë Krasniqi, në Kosovë është krijuar një realitet i ri – shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës, duke i theksuar edhe hapat e domosdoshëm në këtë drejtin, si: miratimi i Deklaratës së Pavarësisë, miratimi i flamurit, i stemës dhe miratimi i Kushtetutës. Kësisoj, ka pohuar kreu i legjislativit të vendit, Kosova e ka përmbyllur misionin shtetformues të saj, duke hapur perspektiva të zhvillimit të të gjithë qytetarëve të



saj. Ai i ka garantuar parlamentarët e NATO-s se Kushtetuta e Kosovës sublimon në vete Planin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit, që u garanton të gjithë qytetarëve të Kosovës zhvillim të papenguar.

Krasniqi në vazhdim ka theksuar se populli dhe institucionet e Kosovës kanë për synim integrimin në mekanizmat evropianë dhe euroatlantikë, si dhe anëtarësimin në Fondim Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore dhe në forume të tjera ndërkombëtare.

Kryesuesi i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Michael Clapham, por edhe anëtarë të tjerë të delegacionit kanë shfaqur interesime për zhvillime të pritshme në Kosovë dhe kanë shtruar shumë pyetje për qën-

drimet që do të mbajë Kuvendi dhe forcat përfaqësuese në Kuvend, sidomos ato të minoriteteve.

Anëtari i Kryesisë, Slobodan Petroviq, është shprehur se tani të gjithë qytetarëve të Kosovës u nevojitet mirëqenie dhe zhvillim, si dhe institucione legjitime demokratike. Sikur popullata serbe e Kosovës të mos i bojkotonte zgjedhjet parlamentare, serbët do të përfaqësoheshin me më shumë se njëzet deputetë, ka thënë ai. Petroviq, ndërkaq, ka folur edhe për presionet e fuqishme që ka pasur Grupi Parlamentar i SLS-së, për të hequr dorë nga politika e mirëbesimit ndërmjet komuniteteve në Kosovë.

Xhezair Murat ka theksuar se komunitetet që përfaqëson (boshnjak dhe turq) kanë ndalë në zgjedhje

në përqindje edhe më të lartë se shqiptarët dhe se këto komunitete janë luajale ndaj institucioneve të vendit dhe duan të integrohen plotësisht në shoqërinë e Kosovës. Nexhat Daci ka theksuar se opozita ka qenë plotësisht unike me forcat e pozitës për sa i përket projektit të shtetformimit dhe krijimit të ambientit të sigurt.

Naim Maloku, ndërkaq, ka dhënë shpjegime për pasojat e protestave serbe në Mitrovicën e Veriut dhe për ndërmarrje të tjera nga Serbia për destabilizimin e Kosovës, duke u fokusuar sidomos në zgjedhjet lokale serbe në Kosovë, që ka paralajmëruar Beogradin.

Sabri Hamiti duke folur për mbështetjen që e pret Kosova edhe nga Asambleja Parlamentare e NATO-s, ka pohuar se KFOR-i që nga fillimi ka qenë dhe mbetet institucioni më i besueshëm në Kosovë. Ai ka theksuar se me zgjedhjet lokale serbe në Kosovë, Beogradin dëshiron ta testojë pavarësinë e vendit tonë dhe seriozitetin e institucioneve të Kosovës dhe të atyre ndërkom-bëtare, të pranishme këtu.

Kryeparlamentari Krasniqi duke përkujtuar se Kushtetuta e Kosovës parasheh dyshtetësinë, prandaj edhe mundësinë e votimit për Parlamentin e Serbisë, ka tërhequr vëmendjen se mbajtja eventuale e zgjedhjeve lokale serbe në Kosovë, do të pengojë integrimin e qytetarëve serbë në institucionet dhe në shoqërinë e Kosovës.

Kryesuesi i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Michael Clapham, në bisedë me kryeparlamentarin Krasniqi dhe anëtarët e Kryesisë është shprehur se Kuvendi i Kosovës është i mirëpritur në takimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

PYETJE TË DEPUTETËVE QË NUK MORËN PËRGGJIGJE

Në seanca të Kuvendit të Kosovës deputetet kanë shtruar disa pyetje, në të cilat përkundër përsëritjes së tyre, në seanca vijuese, nuk kanë marrë përgjigje. Pyetjet janë shtruar gjatë muajve mars dhe prill të këtij viti, kurse deri nga fundi i qershorit nuk kanë marrë përgjigje nga kryeministri, ose ministrinë përkatëse, të cilëve iu kanë drejtuar.

Nisur nga fakti se numri i studentëve që përfundojnë studimet themelore në Universitetin e Prishtinës është dukshëm më i lartë se mundësitë e pranimit të tyre në shkollën e tretë të studimeve, deputetja **Njomza Emmini** i ka drejtuar këtë pyetje ministrit të Arsimit dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj: :”Si planifikon ta adresojë këtë problem MASHT-i dhe sa shfrytëzohen fondacionet dhe resurset tjera akademike, si: DAAD, Ëus Austria etj., që veprojnë në Kosovë me qëllim të krijimit të mundësive për studime postdiplomike jashtë vendit?

Deputeti **Esat Brajshori** i ka shtruar këtë pyetje ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, z. Fatmir Limaj: “Kur do ta ketë Republika e Kosovës Kodin Shtetëror për shërbime telefonike?

Deputeti **Riza Smaka**, nisur nga fakti i i prerjes dhe shfrytëzimit ilegal të pyjeve që kanë si pasojë dëme të mëdha, i shtroi pyetje kryeministrit Hashim Thaçi se çfarë masa ndërmerr Qeveria e Kosovës në funksion të ruajtjes, mbrojtjes dhe kultivimit të pyjeve kosovare, përkatësisht nxitjes “bona fidei” të sendërtimit të pikave programore konkrete të Qeverisë së Kosovës?

Deputetja **Myrvete Pantina** i shtroi këtë pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Idriz Vehapi:”Pse në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2008 nuk ka ndarje të mjeteve në emër të subvencioneve për përkrahjen e prodhuesve bujqësorë?

Deputeti **Riza Smaka** i ka shtruar pyetje kryeministrit Thaçi lidhur me atë se çfarë ndërmerret nga Qeveria e Kosovës për ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave të Kosovës, të cilat sistematikisht dhe në mënyrë të pakontrollueshme uzurpohen arbitrarisht nga individë dhe grupe individësh?

Deputeti **Emrush Xhemajli** iu ka drejtuar ministrit të Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Mahir Jakhillar me këtë pyetje:” A jeni në dijeni se në Pemishten në dalje të Ferizajt, në drejtim të Shtimes, ka mbetur qe sa vjet rreth një tonë material i rrezikshëm për ambientin, pesticide të skaduara, të cilat po bëjnë dëm dhe çka keni ndërmarrë për t’i larguar ato?

Deputeti **Sabit Rrahmani** i ka shtruar këtë pyetje kryeministrit Thaçi:” Pse në Komunën e Lipjanit, ku është vetëm një përfaqësues i pakicave nga partia “Bashkimi Demokratik i Ashkalinjve”, z. Hasan Abdullahu, edhe pse është këshilltar i zgjedhur me vota, nuk ka marrë postin e zëvendës kryesuesit, por në vend të tij është zgjedhur pjesëtari nga minoriteti serb, i cili nuk është fare këshilltar i Kuvendit Komunal, por është propozuar nga partia serbe”.

Deputeti **Riza Smaka** iu ka drejtuar më një pyetje kryeministrit Thaçi përkitazi me faktin se disa persona fizikë e juridikë të pandërgjegjshëm sistematikisht gërryjnë shtretërit e lumenjve, duke sjellë shumë pasoja, si: shterje dhe ndryshime të rrjedhave natyrore ujore, evazione fiskale në dëm të parasë publike dhe dëmtime të rrugëve, në vështrimin se çfarë ndërmerr Qeveria e Kosovës për pengimin e këtyre dukurive?

Deputetja **Luljeta Shehu** i ka shtruar këtë pyetje ministres së Energjetikës, Justina Pula:” Si është mundësia e shlyerjes së borxhit të rrymës për familjet e dëshmorëve, të pagjeturëve dhe rastet sociale prej vitit 1999 deri 2007, me qëllim që prej 2008 të fillohet të bëhet pagesa e rregulltë e rrymës për familjet e përmendura?”

Deputeti **Berat Luzha** i ka shtruar këtë pyetje ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti:” Gjendja e përgjithëshme dhe sidomos ajo e sigurisë në fshatin Debëllde dhe në rrethinën e tij kohëve të fundit është përkeqësuar. Fshatarët, të shqetësuar tej mase, duket se po vetorganizohen për t’i mbrojtur pronat e tyre të ligjshme, Çka ka bërë Ministria juaj në mënyrë që fshatrat të mos i përdorin metodat më ekstreme për t’i mbrojtur pronat e tyre, të cilat njëkohësisht janë edhe territor i ligjshëm i Republikës së Kosovës?”

Disa anëtarë të Komisionit e kritikuan punën e UNDP-së

Deri në fund të marsit të vitit 2008, përmes këtij programi, 321 familje me rreth 1.560 anëtarë, kanë marrë leje për dhënien e ndihmës për banim, ndërsa edhe rreth 200 familje (përafërsisht me rreth 1.300 anëtarë) presin që t'u jepet leja për ndihmën e këtyllë

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i kryesuar nga z. Bojan Stojanoviq, kryetar i Komisionit, mbajti sot mbledhjen e rregullt në të cilën pikë kryesore e rendit të ditës ishte shqyrtimi i raportit lidhur me ndihmën për kthim të pakicave në Kosovë (SPAK PLUS), që e kishte përgatitur UNDP, më saktësisht Agjencia Partneriteti i Qëndrueshëm për Ndhimë të Kthimit të Pakicave në Kosovë. Raportin e lart theksuar e prezantoi menaxheri kryesor i Agjencisë Partneriteti i qëndrueshëm për ndihmë të kthimit të pakicave në Kosovë, z. Kim Vetting.

Në këtë mbledhje, duke folur për procesin e kthimit të pakicave në Kosovë, z. Kim Vetting theksoi që ky program (SPAK PLUS) filloi së aplikuari qysh në tetor të vitit 2005 dhe se i njëjti ofron një mekanizëm integral të ndihmës që është në dispozicion të të kthyerve dhe që është kombinuar, si për mbështetjen e kthimit të organizuar grupor, ashtu edhe të kthimit individual në Kosovë. Vlen të theksohet që, me qëllim të realizimit sa më të mirë të programit të përmendur të UNDP-së, Agjencia Partneriteti i qëndrueshëm për ndihmë të kthimit të pakicave në Kosovë, ka një

bashkëpunim të ngushtë dhe koordinim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, si dhe me qeveritë lokale që janë të vëzhguara drejtë për së drejti në procesin e kthimit të të gjithë atyre që kanë jetuar dhe punuar në Kosovë deri në vitin 1999. Qëllim kryesor i këtij programi-do të thotë i Programit SPAK PLUS ka qenë ndihma për një kthim të qëndrueshëm dhe riintegrim të atyre që kthehen, qoftë në mënyrë të organizuar, qoftë në formë individuale në Kosovë.

Në vazhdim, z. Vetting theksoi që deri në fund të marsit të vitit 2008, përmes këtij programi, 321 familje (me rreth 1.560 anëtarë) kanë marrë leje për dhënien e ndihmës banesore, ndërsa edhe 200 familje të tjera, me rreth 1.300 anëtarë) presin që ta marrin lejen për ndihmën e këtyllë. Deri në fund të vitit 2008, në tërë territorin e Kosovës, u krye ndërtimi i gjithsej 273 shtëpive për të kthyerit dhe deri në fund të vitit 2008, kërkesën për këtë lloj ndihme e kanë parashtruar edhe 210 familje. Përmes programit të theksuar më lartë, në formë të shërbimeve dhe ndihmës socio-ekonomike, deri në fund të prillit të vitit 2008 është siguruar ndihmë për rreth 300 familje, pra

kyçja e tyre në këtë program. Në fund të fjalës së tij, z. Vetting theksoi që përafërsisht 3.000 familje kanë shprehur dëshirën për t'u kyçur në procesin e kthimit, përkatësisht janë kyçur në projektin SPAK PLUS.

Në vazhdim të punës së kësaj mbledhjeje, disa nga anëtarët e Komisionit kritikuan punën e UNDP-së, përkatësisht realizimin e Programit SPAK PLUS, para se gjithash për faktin se projektet për kthimin e pakicave në Kosovë nuk kanë qenë të shpërndara në mënyrë të barabartë, por në shumë raste është favorizuar vetëm një bashkësi. Kritika mjaft të mëdha për punën e deritashme rreth kthimit të pakicave në Kosovë shkuan edhe në emër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, si dhe në adresë të zyrave komunale për komunitete, të cilat nuk i kanë përmbushur në tërësi detyrimet e tyre që dalin nga fushëveprimi i punës dhe që kanë qenë të obliguara t'i realizojnë. Po ashtu, kishte propozime për nxjerrjen e Ligjit për kthim dhe gjetjen e mekanizmit përmes së cilit do të kontrollohej realizimi i projekteve për kthim, sepse deri më tani në raste të shumta mjetet e destinuar për këtë lloj ndihme janë keqpërdorur.

XHAVIT HALITI MORI PJESË NË KONFERENCËN E KRYETARËVE TË PARLAMENTEVE TË EVROPËS JUG-LINDORE

Për herë të parë Kuvendi i Republikës së Kosovës përfaqësohet në Konferencën e shtatë të Kryetarëve të Parlamenteve të Evropës Jug-Lindore, e cila u mbajt në Sofje të Bullgarisë, më 13-15 prill 2008, organizuar nga Procesi Bashkëpunues i Evropës Jug-Lindore (SEECP), që është trashëgues i Paktit të Stabilitetit. Parlamenti i Bullgarisë ishte nikoqir i Konferencës, pasi që ka edhe Kryesinë e Këshillit për këtë vit.

Kuvendi i Kosovës është përfaqësuar nga z. Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit. Delegacione e tjera që moën pjesë në këtë konferencë vinin nga Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Greqia, Rumania, Mali i Zi, Moldavia, Serbia, Turqia, Sllovenia si dhe delegacione nga Pakti



i Stabilitetit dhe Parlamenti Evropian. Gjatë fjalës së tij në këtë konferencë z. Haliti i ka njoftuar pjesëmarrësit e saj për arritjet që ka bërë Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet dy komisioneve parlamentare (Komisionit për Punë të Jashtme dhe atij për Integritet Evropian) për përmirësimin e bashkëpunimit ndërparlamentar në rajon dhe më gjerë. Ai ka pohuar se Kuvendi i Kosovës do të vazhdojë bashkëpunimin me të gjitha parlamentet nga rajoni dhe më gjerë. Gjatë fjalimit të tij Haliti ka theksuar arritjet e mëdha që janë bërë me aprovimin e Kushtetutës lidhur me të drejtat e komuniteteve, religjioneve, decentralizimin dhe mbrojtjen e të drejtave kulturore dhe të trashëgimisë religjioze. Siç edhe është bërë praktikë në takime

dhe konferenca të ndryshme multilaterale ku delegacioni i Kosovës merr pjesë, gjatë fjalimit të z. Haliti, delegacioni nga Serbia i udhëhequr nga z. Miloljub Albijaniç, zëvendës kryetar i Parlamentit të Serbisë, e lëshoi mbledhjen, për ty kthyer më vonë.

Z. Haliti falënderoi shtetet që e kanë njohur Republikën e Kosovës, dhe gjatë një numri të takimeve bilaterale me kryetarë dhe zëvendëskryetarë të parlamenteve të rajonit theksoi se Kosova është dhe do të vazhdojë të jetë faktor stabiliteti. Ai gjatë këtyre takimeve me përfaqësues të shteteve të Evropës Jug-Lindore, që nuk e kanë njohur Pavarësinë e Republikës së Kosovës, u kërkoi që të bëjnë atë sa më shpejtë të jetë e mundur.

Iniciativa të tjera për bashkëpunim ndërparlamentar në të ardhmen, do të diskutohen të premtën, me rastin e vizitës së delegacionit nga Parlamenti Evropian në Kuvendin e Kosovës.

SABRI HAMITI, PRITI ZËVENDËSMINISTREN E PUNËVE TË JASHTME TË NORVEGJISË, ELIZABETH WALAN

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës, Sabri Hamiti, priti sot zëvendësmministren e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Elizabeth Walan, e cila ishte e shoqëruar edhe nga përfaqësues të Mi-



sionit diplomatik norvegjez në Kosovë. Me këtë rast znj. Elizabeth Walan shprehu kënaqësinë që pas një muaji nga njohja e pavarësisë së Kosovës nga ana e Norvegjisë, sheh një zhvillim impresiv në Kosovë në përballimin e ngjarjeve të ndodhura dhe të pritshme. Ajo gjatë bisedës u interesua për zhvillimet e ardhshme pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15

qershor të këtij viti. Në vijim Elizabeth Walan shprehu interesimin e Norvegjisë për zhvillimin e Kosovës në aspektin politik dhe ekonomik, në mënyrë që të krijohet një bazë e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Në këtë frymë u theksua se shteti norvegjez gjatë këtij viti do të ndihmojë Kosovën me 15, 5 milionë euro. Zëvendësmministria u interesua edhe për reflektimin e zgjedhjeve serbe në Kosovë. Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës, Sabri Hamiti, falënderoi zëvendësmministren dhe shtetin norvegjez për njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe për ndih-

mën e vazhdueshme të Norvegjisë ndaj Kosovës. Hamiti theksoi se institucionet dhe qytetarët e Kosovës do ta realizojnë me maturi lirinë dhe pavarësinë e fituar. Është koha, tha më tutje Sabri Hamiti, të merren përgjegjësitë për zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe për njohjen dhe koordinimin me partnerët ndërkombëtarë. Ai theksoi se pretendimi i Serbisë për të organizuar zgjedhje në Kosovë është ilegal, ky është një provokacion politik ndaj pavarësisë së Kosovës. Zgjedhje legale në Kosovë tash për tash mund të thërrasë vetëm UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës. Qytetarët dhe institucionet e Kosovës kanë maturinë që të mos provokohen nga gjestet politike të Beogradit, tha Hamiti.

Edhe niveli i punës në Shërbime Publike është rritur. Gjithashtu, Kosova në këtë periudhë ka filluar të ndërtojë të gjitha institucionet funksionale shtetërore. Është nominuar ministri për Punë të Jashtme. Në ditët e ardhshme do të formohen edhe Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Inteligent i Republikës së Kosovës. Është rregulluar, është përgatitur baza ligjore dhe do të procedohet edhe në Kuvend sa i përket Shërbimit Inteligent të Kosovës.

Gjithashtu, është rritur përkushtimi dhe investimi në bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor, por është bërë një punë shumë e mirë nga ana e ministrit për Kthim në çështjet e kthimit të zhvendosurve, që Kosova definitivisht të vazhdojë të ndërtojë realitetin, se Kosova është atdhe i gjithë qytetarëve, Kosova është vend demokratik.

Përkushtim i Qeverisë në konsolidimin e institucioneve

Në vijim në rendin e ditës së seancës ishte Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011. Para deputetëve Programin e paraqiti, kryeministri Hashim Thaçi, i cilin që në fillim theksoi se Programi qeveritar paraqet bazat për Kosovën shtet të qytetarëve, të zhvilluar në përputhje me parimet demokratike, të një ekonomie të lirë dhe të qëndrueshme, të një mjedisi shumetnikë dhe të përkushtuar qartas në drejtim të proceseve euro-atlantike.

Në vijim kryeministri Thaçi tha se Republika e Kosovës po kalon në fazën e tranzicionit dhe në këtë program jemi fokusuar në artikullimin e kërkesave imediate të kësaj faze. Qeveria parqet këtë

program, duke u bazuar në mundësitë e potencialet e saj dhe të vendit tonë.

Ky Program ka për qëllim menaxhimin e këtyre mundësive: zhvillimin strategjik të vendit tonë dhe krijimin e një pozite të favorshme në politikën ndërkombëtare.

Arsimi – prioritet nga më të rëndësishmit

Në këtë program, si prioritet i Qeverisë, prej më të rëndësishmëve, është arsimi. Është hartuar strategjia zhvillimore që do të sjellë një investim afatgjatë në kapitalin njerëzor. Sundimi i ligjit, sigurimi i një vendi ku sundon ligji, me kompletim dhe harmonizim të sistemit juridik, me një sistem gjyqësor dhe prokurorial të pavarur dhe të paanshëm dhe ngritja e kushteve për të punësuarit në këtë sistem, si dhe bashkëpunimi me agjencionet tjera vendore dhe ndërkombëtare në luftën ndaj krimit të organizuar. Kjo do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në imazhin e Republikës sonë, në përshpejtimin e integritimeve euro-atlantike, të krijojmë prioritetet që Qeveria jonë të angazhohet maksimalisht t'i implementojë. Rezultatet e para janë të prekshme.

Me këtë program synojmë të kemi një ambient të sigurt në tërë territorin e Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ky Program mundëson krijimin e planeve për menaxhimin e situatave emergjente.

Pajisja e qytetarëve me dokumente civile shtetërore të Kosovës do të jetë preokupim i menjëhershëm i Qeverisë. Ky projekt tashmë ka filluar.

Në sektorin financiar, gjithashtu do të angazhohemi për zvogëlimin e interesave që janë relativisht të

larta dhe jo shumë stimuluese për investime. Vetëm në tremujorin e parë, me qeverisjen e mirë, me stabilitetin, me sundimin e Ligjit, me luftën kundër korrupsionit, kemi vërshim të investitorëve ndërkombëtarë që kanë siguri, kanë mbështetje, kanë adresë të sigurt, e kanë Qeverinë e Kosovës dhe ky Program vetëm do të hapë perspektivë. Vetëm dje kemi prezantuar një program të krijimit të mundësive për investitorët ndërkombëtarë, në partneritet me atë vendor me vlerë rreth 250 milion euro.

Qeveria e Kosovës ka ndërtuar politikë të qëndrueshme të partneritetit me biznesin kosovar dhe biznesi kosovar nuk do të vazhdojë të jetë si edhe më herët i shantazhuar, i kërcënuar, por do të jetë partner i ndihmuar dhe i favorizuar nga Qeveria e Kosovës.

Implementimi i statusit, shteti funksional dhe demokratik dhe implementimi i plotë i marrëveshjes së statusit do të jetë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Edhe krijimi i institucioneve të reja në nivel qendror dhe lokal do të bëhet në këtë rrugë. Në këtë drejtim do të krijojmë misione diplomatike në botë, ambasada, por edhe forcën e sigurisë, si njësi profesionale. Në të njëjtën kohë, do të vazhdojmë për të transformuar edhe TMK-në, si dhe institucionet e tjera që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë, minoritetet, decentralizimin.

Programi mundëson përkrahjen konkrete të zhvillimit dhe të integritetit të bashkësive etnike, duke u përkrahur dhe financuar nga Qeveria e Kosovës. Kjo do të garantojë një kthim të qëndrueshëm individual dhe të organizuar, si dhe angazhim në koordinimin e fondeve shtesë, përveç atyre nga Buxheti i kon-

soliduar i Kosovës.

Ky kthim nënkupton edhe integrimin e komuniteteve në këtë fushë, do të bashkëpunojmë me institucionet qendrore me ato lokale, vendore dhe ndërkombëtare, me OJQ-të, shoqërinë civile, mediat dhe gjithë potencialin kosovar dhe atë ndërkombëtar.

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës është e përfshirë në këtë program duke paraparë përshpejtimin e procesit të njohjes së shtetit të Kosovës, thellimin e marrëdhënieve të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e Bashkimit Evropian, shtetet fqinje, ndërtimin e shërbimit diplomatik dhe konsullor të Kosovës, anëtarësimin e plotë të vendit tonë në organizatat dhe institucionet kryesore, politike, ekonomike dhe financiare ndërkombëtare, mbrojtjen e interesave të qytetarëve tanë në botën e jashtme, si dhe afirmimin e identitetit të Kosovës në botën e jashtme.

Qeverisja e mirë është një nga preokupimet dhe zotimet e Qeverisë sonë. Përcaktimi i qartë i kompetencave dhe i përgjegjësive në të gjitha fushat dhe veprimtaritë, shërbimet e mira dhe transparente, llogaridhënia për shpenzimet e parasë publike, reforma në administratën publike dhe veprimet tjera që sigurojnë qeverisje të mirë, janë pjesë e këtij programi dhe zotim i imi dhe i gjithë ministrave. Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social ofrohet si prioritet i përherëshëm dhe afatgjatë. Ndihma sociale për familjet e varfra është qëllim kryesor që bëhet nga një sistem i mbrojtjes sociale për personat që nuk mund t'i ndihmojnë vetvetes e familjes, që Qeveria t'ju ndihmojë me garantimin e të ardhurave minimale për jetesë me dinjitet. Këtu përfshihet edhe kujdesi

shëndetësor dhe shkollimi i fëmijëve që jetojnë në varfëri.

Struktura e re e popullatës është një pozicion shumë efikas dhe Qeveria parasheh politika multisektoriale, duke dhënë mundësi të favorizimit të rinisë kosovare dhe të bashkëpunimit në nivel qendror dhe lokal, atë vendor, ndërkombëtar, si dhe bashkëpunimin me organizatat joqeveritare.

Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banceve, do të krijojë një mundësi për zhvillimin e shumanshëm të Kosovës, duke lehtësuar dukshëm hartimin e politikave zhvillimore të vendit.

Diaspora jonë e fortë dhe numerikisht e madhe, ka nevojë që të ketë përkujdesje të Qeverisë dhe krijimin e mundësive për hartimin e politikave që lehtësojnë komunikimin e tyre me vendin dhe i informojnë njerëzit jashtë vendit për zhvillimet në Kosovë.

Mbështetje për Programin e Qeverisë

Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në fjalën e tij u shpreh se Programi i ofruar, vërtet



është program i persepëktivës së Republikës së Kosovës. Ai falënderoi Kryeministrin për ndërrimin e një koncepti të çuditshëm, të një maksime popullore nga e thëna në të bërë, është në mes një det i tërë. “Ju, në radhë të parë e

keni bërë, e pastaj na keni thënë, dhe kjo është mirë në kuptimin më pozitiv të mundshëm, sepse keni dashur që vërtet të mos përfilisni rreth asaj kornize që na pat kornizuar e lidhur këmbët, por të flisni me logjikën e Kushtetutës së Kosovës. Unë falënderoj edhe opozitën e nderuar, sepse mbase po të isha në pozitën e juaj, kështu do të kisha bërë si ju. Por, e kuptojmë pozicionin tuaj, sinqerisht e kuptojmë dhe ju falënderojmë që po përpiqeni për t’u konsoliduar dhe vërtet kjo është e mirë, sepse nuk ka mundësi të ketë Qeveri të fortë pa një opozitë të fortë.

Unë uroj që sa më parë të konsolidohet dhe të forcohet opozita për ta sfiduar seriozisht Qeverinë aktuale. Por, unë zotëri Kryeministër, vërtet u jam shumë mirënjohës, sepse unë po ndihem mirë në këtë pozicion që jam, me punët, angazhimin konkret që ka bërë dhe po bën Qeveria aktuale e Kosovës. Unë po ndihem mirë në rrugë, sepse tani pres 10 deri 20 minuta për të shkuar në një vend të caktuar, sepse punohet në rrugët e Kosovës. Unë po ndihem shumë mirë, në këtë pozicion edhe nga fakti se e kemi caktuar si prioritet arsimin në Kosovë, dhe në fakt po punohet seriozisht për arsimin në Kosovë”, theksoi Buja.

Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, **Lutfi Haziri** mbështeti Programin qeveritar. “Mbështetja jonë bazohet në angazhimin tonë edhe duke qenë partneri kryesor i qeverisjes, edhe duke qenë të vetëdijshëm se ministrat nga radhët e LDK-së në Kabinet kanë marrë pjesë aktive në punimin e këtij Programi punues. Ministrat kanë qenë pjesë e angazhimeve konkrete për ta pasuruar vizionin apo për ta zbërthyer këtë version në program politik për një periudhë më afatg-



jate. Natyrisht që besojmë thellë, si grup parlamentar, që ky Program, kjo bazë programore e mirë për të ardhmen e Kosovës, ka politikat e qarta sektoriale, të ndërtaura në afate kohore, në programe ditore, javore, periodike dhe, po ashtu, përgjegjësia që ndërtohet në raport me ne legjislativin, do të respektohet jashtëzakonisht shumë.

Natyrisht, deputetët nga radhët e LDK-së, përveç mbështetjes që i bëjnë programit, do ta pasurojnë me diskutimet e veta. Ata janë ftuar sot që të jenë pjesë konstruktive e këtij debati, duke dashur që roli ynë të jetë edhe më produktiv, në mënyrë që programi ynë, në kuadër të këtij Kabineti, vërtet të rezultojë me suksese, me angazhimet tona të përbashkëta ta përmirësojmë jetën. Përshëndes edhe njëherë paraqitjen tuaj përmes kësaj informate që e dhatë të 100 - ditorit, dhe kjo ditë ka qenë e veçantë në kuadër të angazhimeve tona, sepse Presidenti adresoi fjalën e tij dhe adresimi ishte i lidhur ngushtë edhe me këtë program, edhe me kërkesën e tij, si figura më e lartë e unitetit të vendit, që institucionet tona dhe ne të angazhohemi në realizimin e programeve tona.

Andaj, kjo ndërlihdje e angazhimeve dhe kjo paraqitje e raportit sot këtu, tregon qartas se Qeveria ka marrë mbi vete barrën e madhe të realizimit të këtij programi, për të cilin ne nuk kemi

asnjë dyshim”, theksoi Haziri

Buxheti edhe ashtu është shumë i ulët për t’i mbuluar skemat sociale

Deputeti **Ibrahim Gashi** nga AKR-ja, njëherësh anëtar i Kryesisë së Kuvendit, theksoi se opozita sot po dëshmon konstruktivitet dhe pjekuri të lartë politike dhe me këtë po dëshmon se është po aq për shtetësinë e Kosovën, sa të gjithë të tjerët që janë këtu.

Problemi kryesor tek programi i



Qeverisë, i ofruar në versionin çfarë është ofruar në fakt, është qasja e tij, janë më tepër qëllime që mund të formulohen lehtë në letër, por është mungesa kryesore e ofrimit të mekanizmave të qartë, që sjellin deri tek qëllimi. Pra, nuk siguron asnjë garanci të prekshme kundër deficitit implementues. Ta zëmë, i tërë raporti përbëhet nga qëllime madhore dhe detaje minore. Gjëja më e detajizuar është se, do të citoj: “do të miratohet kjo strategji, do të bëhet ky plan”, por ajo që ka nevojë të thuhet është: “do të implementohet kjo strategji, do të implementohet ky plan”.

Është e rëndësishme të kuptohet drejt ky paragraf, sepse i tërë programi, veçanërisht politikat sektoriale, bujqësia, telekomunikacioni, arsimit, janë të një fryme të tillë. Përpos asaj që secili mund të kuptojë se është një lulishte e vërtetë, Planit i mungon konsistenca dhe

ka diskrepancë të vazhdueshme. Nëse thuhet se do të rishqyrtohen politikat fiskale, që unë e kuptoj, lexo: “uljen e tatimeve”, me qëllim të përmirësimit të shkallës së konkurrencës, në aspektin rajonal dhe në të njëjtën kohë proklamohet zgjerimi i skemës sociale pa precizuar se si do të mbulohej kjo pjesë e humbjeve në bazën buxhetore, për mua është goxha e pakuptueshme. Kjo i bie kështu, për shembull: nëse tatimi në korporata ka qenë 20% dhe nëse Kosova ka mbledhur 150 milionë euro nga kjo, atëherë këtu humben rrafsh 70 milionë euro. Nga kjo rezulton që buxheti në krahasim me atë të kaluarin, do të jetë 75 milionë më i ulët. Buxheti edhe ashtu është shumë i ulët, shumë i vogël për t’u mbuluar skemat sociale e lëre më të flitet edhe për shpenzimet shtesë.

Tek zhvillimi ekonomik, shtetet zakonisht kanë 2 -3 instrumente për të infuzionuar ekonominë, politikën fiskale, politikën monetare, huat, por një mund të jetë edhe investimi në kapitalin social, përkatësisht në njerëzit e mençëm, pra investimin në mendje.

Kosova nuk ka politikë monetare, huat nga jashtë janë shumë të limituara në mungesë të kapitalit financiar shtetëror, atëherë mbetet politika fiskale dhe kushtimisht edhe investimi në kuadro. Për arsyet që i përmenda më herët, politika fiskale është shumë e ndjeshme. Zvogëlimi i tatimeve, sado që në një shkallë të caktuar edhe mund të ndikojë në zhvillimin ekonomik, përmes atraktivitetit të investimeve të huaja, nuk të jep siguri të mjaftueshme se kjo do të funksionojë. Për shembull, Mali i Zi i ka ulur tatimet tej mase për 5 vjetët e shkuar, por kjo nuk ka ndikuar që të ketë trende pozitive të rritjes ekonomike, andaj nuk ka

ndonjë plotësim apo arsyetim në këtë rast se çka do të bëhet në rast se ndodhë e njëjta gjë.

Plani nuk ofron asnjë instrument mbrojtës nga shoku asimetrik, rastet emergjente, tërmetet, fatkeqësitë elementare. Domethënë, nuk ofron asnjë mënyrë apo politikë që e mbron popullatën nga rritja e çmimeve globale, gruri, nafta, vaji etj. Këto janë komoditete përbërëse të secilit racion ushqimor dhe të prodhimit. Kjo i ngjan arsyetimit të Qeverisë së kaluar, kur thoshte se nuk ka ku të stacionojë rezervat e grurit, prandaj nuk kemi rezerva shtetërore.

Dy paradokse

Shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, theksoi se është mirë që në këtë fatkeqësi,



është një fat që të gjithë njerëzit janë dëshmitarë dhe shohin se çka ndodh. Ky është fati, fat i mirë është që kemi Kuvend ku flitet dhe që njerëzit shohin. Do t'i përmendi fillimisht vetëm dy paradokse që i kam vërejtur këtu të vogla. Presidenti i Kosovës, në fjalën e tij, e cila lidhet me Programin e Qeverisë edhe me Reportin 100-ditësh, thotë se universitetet nuk guxojnë të jenë institucione profitabile. Ju lutem, në të njëjtën kohë Kryeministri thotë: 100% ekonomi të tregut. Merruni vesh në mes veti njerëz,

se janë të ndryshme këto çështje, nuk janë bashkë.

Ky program i Qeverisë nuk e përmban as edhe një datë të vetme përpos datës 17 shkurt. As edhe një numër të vetëm përpos numrave të paragrafëve, 3.1.6, 3.1.7 etj. Këto janë. Sikur ta kishim parë një element programor, i cili thotë: Taksat në duhan dhe në alkool, të cilat i marrim sot, gjenerojnë 1 milion euro në buxhet, ne do t'i dyfishojmë këto taksa dhe do t'i nxjerrim 2 milionë euro, dhe me ato 2 milionë euro do t'ua rrisim nga 1000 euro mësuesve, ne kishin parë që ka program, se po shihet kur fillon, kur mbaron, cilat janë shifrat.

Tjetra është se kjo Qeveri, as pas 100 ditëve të punës nuk ka mbërritur të nxjerrë diçka të qartë në letër edhe të vijë e të na tregojë, kështu duam të bëjmë. Fjalitë kryesore të cilat gjenden në këtë program janë: do të provojmë, do të tentojmë t'i gjejmë mënyrat etj. Shikoni, për shembull, te pensionet, vetëm te pensionet. Nxirrni programin dhe shihni. Të gjitha premtimet janë bërë për pensione në Kosovë, vetëm tre reshta ekzistojnë në program.

Nëse përpos programit, tani shikohet edhe strategjia legjislative, të cilën e kemi marrë më herët dhe bashkohen të dyja, shihet me të vërtetë që nuk ka asnjë sens më të voglin të qeverisjes. Ajo nuk është strategji, është listë e ligjeve të cilën e kemi lënë ne, ndërsa zëvendëskryeministri më 3 mars thotë: 170 ligje kemi për t'i sjellë, 50 i kemi kaluar, kanë qenë gati, edhe nja 20 të tjera janë gati, të tjerat nuk kanë nisur as të bëhen. Shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, përkitazi me Programin e Qeverisë së Kosovës u shpreh me këto fjalë: "Këtë dokument nuk po e quaj pro-



gram. Mund të jetë gjithçka tjetër, vetëm program jo! Mund të jetë koncept, vizion, analizë, gjithçka, në gjithë terminologjinë e mundshme, mund ta përdorim dhe ta adresojmë në kuadër të këtij dokumenti, vetëm program jo. 80% ose më shumë se 80% të pjesës përbërëse të këtij dokumenti nuk gjason në Program, nuk ka objektiva programore. Nuk ka elemente që mund ta identifikojmë se vërtet cila është baza mbi të cilën është mbështetur koncepti i kësaj Qeverie. Është vështirë edhe të flitet për këtë dokument. Mua, me të vërtetë më vjen shumë keq për një partner të koalicionit qeverisës, i cili, të paktën, ka pasur një traditë, ka pasur një kulturë sidomos në hartimin e dokumenteve. Dhe, ajo çfarë do të them tash, do të ishte, vërtet, a kanë marrë pjesë ministrat e Kabinetit Qeveritar në hartimin e këtij dokumenti? Nëse po, atëherë kjo është më shumë se skandaloze. Kjo Qeveri do të mbahet mend sepse pas 100 ditëve të punës së vet na ka ofruar një dokument që është mëdyshje më e madhe se si ka arritur të punojë në mënyrë ad-hoc në realizimin e punëve të përditshme, do të thosha. Është folur shumë se "s'kemi pasur kohë". Është folur shumë se "ka qenë periudha e statusit të Kosovës". Me të vërtetë është një mega-deklaratë që është adresuar nga ana e Qeverisë. Mirëpo, në qoftë se kemi për bazë atë çfarë na

ka servuar në këtë dokument, më herët e quajta skandaloze, dhe tash them: shikoni vetëm një element me shumë eufori. Kjo Qeveri përmes këtij dokumenti, thotë: “katër prioritete të kësaj Qeverie – rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e papunësisë, e varfërisë dhe stabilitetit social”. A e dini kujt gjason kjo frazë? Standardet para statusit! Njëherë ta zhvillojnë ekonomikisht vendin, pastaj ta implementojmë statusin dhe, tek dikur më vonë, të fillojnë zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin apo stabilitetin social. Do të thotë, krejt mbrapsht. Është vërtet shumë vështirë të gjesh element që mund të thirresh në programin e kësaj Qeverie. Mirëpo, me shumë keqardhje që e vlerësoi mjaft punën që është kah e bën, arsimi nuk është prioritet i kësaj Qeverie, siç është proklamuar kohë më parë dhe nuk shoh të paktën asnjë fjalë që ka të bëjë me hapa konkret përmes këtij dokumenti. Shefi i Grupi Parlamentar “7+”, deputeti **Zylfi Merxha**, theksoi kishte fatin e keq që i ra hise të



flasë pas dy diskutuesve shumë të mëdhenj, që dinë të flasin, “ndërsa unë afër tyre do të dukem shumë i vogël, mirëpo çka të flas do të flas prej zemrës dhe të vërtetën”. Ky Parlament, prej ditës së parë e di si është formuar, në 2001-shin, po ashtu kemi pasur do të dhëna:

jo ky ka punuar, jo ky s’ka punuar, mirëpo askush s’ka thënë se prej që jemi dalë nga lufta shumë kemi bërë, shumë. Fola për të parin. Për të dytin, ia nisi shumë mirë, por nuk zgjati. I treti, çfarë kujtojmë ne. Populli po e di a mundet ndokush për 90 ditë, po edhe ta kishin atë shtagën që thonë “qiribu-qiriba” s’mund të ketë këto merita. Meritat janë të kësaj Qeverie që e kam pas veti, që e udhëheq zoti kryeministër Thaçi me ministrat e vet dhe që ka bërë aq shumë dhe le që jemi Republikë, kemi pavarësinë, por krejt bota u çua në këmbë dhe thotë: kush është kjo Kosovë, sa është kjo Kosovë? Këtë po e harrojmë, sepse ne duam ta ulim dikë, t’ia humbim vlerën dikujt, por t’ia humbësh dikujt vlerën nuk është mirë, ose së paku te jesh real e të thuash, e ke bërë këtë, e këtë, e këtë jo dhe jo, kjo është reale. Ta dini se së shpejti Kosovës do t’ia kenë lakmi për rrugën që e ka marrë.

Programi është i mirë varësisht nga ajo se sa mund të sendërtohet

Në emër të Grupit Parlamentar –SLS, fjalën e mori deputeti **Branislav Grbiq**. Ai tha se është e nevojshme përkrahja e pushtetit, por dhe përkrahja e qytetarëve të Kosovës dhe e të gjithë atyre që dëshirojnë të krijojnë hapësirë në të cilën do të ndihen të gjithë të sigurt dhe do ta shohin të ardhmen e tyre. Prandaj konsideroj se çdo program është i mirë në atë masë sa është i zbatueshëm dhe i pranueshëm për të gjithë, me monitorimin e Komunitetit Ndërkombëtar. Në këtë kontekst jemi të gatshëm ta pranojmë një sfidë që quhet- jeta në Kosovë. Konsideroj se sigurisht opozita ka të drejtë që në kontekst të ekspozesë së tyre, përmes punës së vet, në një pjesë, është e mund-



shme të rregullohen disa çështje. Mendoj se në këtë drejtim ajo ka të drejtë.

Sigurisht se pa opozitë as Programi i Qeverisë nuk mund të jetë i suksesshëm dhe në këtë mënyrë t’i japë shtytje Qeverisë. Në këtë kontekst konsideroj se Qeveria mund të jetë më e fuqishme duke i pasur parasysh qëllimin dhe detyrën që të qëndrojë në rrugën e përcaktuar gjatë mandatit.

Konsideroj se shumëçka mund të përcaktohet. Një nga çështjet kyçe dhe një nga çështjet më pragmatike, siç theksoi kolegu, është Veriu i Mitrovicës. Aty janë problemet e mëhershme që ekzistojnë edhe më tutje dhe të cilat sigurisht do të jenë pjesë e Programit të Qeverisë. Ky është mirëbesimi dhe bashkëjetesa multietnike e komuniteteve për një jetë të përbashkët të tyre në Kosovë.

Kjo Qeveri e ka përpara një problem serioz që duhet të zgjidhet. Mendoj se ajo do të jetë e suksesshme nëse e zgjidh atë problem meqë duhet të përcaktohen shumë çështje për të cilat nevojitet kohë dhe mirëbesim.

Në emër të Grupit Parlamentar dëshiroj që edhe një herë t’ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në këtë program, ndërsa kryeministrin e falënderoj për ekspozenë. Njëkohësisht do ta japim përkrahjen tonë që ky program të jetë i suksesshëm.

NGA VIZITA E DELEGACIONIT TË KOSOVËS NË IRLANDË

Mbështetje për Kosovën, sidomos në planin ekonomik

Një delegacion i Republikës së Kosovës, i përbërë nga znj. Edita Tahiri, Deputete e Kuvendit dhe anëtare e Komisionit për Integritet Evropian dhe z.Driton Qehaja, këshilltar për çështje ekonomike i Kryeministrit, qëndruan në Irlandë në një vizitë pune, prej 14 deri 18 prill 2008 . Me këtë rast delegacioni zhvilloi takime me zyrtarë irlandezë në qeveri, parlament si dhe me përfaqësues të sektorit të biznesit



Gjatë vizitës në Irlandë Edita Tahiri dhe Driton Qehaja janë takuar me Komisionin për Çështje Evropiane të Parlamentit Irlandez, të kryesuar nga Bernard Durkan;

me eurodeputetin Colm Burke, anëtar i Komisionit për politikë të jashtme të Parlamentit Evropian dhe me përfaqësues të Ministrisë së Jashtme, Emma Madigan, zëvendës drejtor për Evropën. Ndërkaq, delegacioni nga Kosova realizoi takime edhe me përfaqësues të biznesit, të Odës Ekonomike të Dublinit dhe të Institutit për Integritet Evropian. Takime u zhvilluan edhe me komunitetin shqiptar në Irlandë dhe mediet irlandeze. Takimi i paraparë me Ministrin për integritet evropian, Dick Roche u anulua për shkak të vdekjes së ish- Presidentit irlandez, Hillary.

Në këto takime delegacioni u shoqërua nga veprimtarja dhe lobistja e njohur për çështjen e Kosovës, z.Valerie Hughes e cila koordinoi këto aktivitete.

Në takimet e zhvilluara Delegacioni i Kosovës falënderoi Qeverinë, Parlamentin dhe popullin e Irlandës për njo-

hjen e pavarësisë së Kosovës si dhe për përkrahjen e vazhdueshme në periudha të rënda.

Delegacioni prezantoi vizionin për shtetin e ri të Kosovës dhe foli për sfidat e pavarësisë së Kosovës. Për vizionin politik të Kosovës si shteti më të ri në botë, foli Edita Tahiri, e cila ndër të tjera tha se Kosova synon të jetë një shtet funksional me vlera të qëndrueshme në sundimin e ligjit, demokracisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e saj; një shtet i integruar në bashkësinë Euro-Atlantike dhe në të gjitha organizmat relevante ndërkombëtarë, përfshirë anëtarësimin në OKB. Ajo theksoi sfidat kryesore të shtetit të ri duke përfshirë objektivat për një ekonomi të qëndrueshme, për një arsimim cilësor të standardeve moderne si dhe për konsolidimin e sovranitetit dhe legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Zonja Tahiri më tej theksoi se për udhëheqjen e Kosovës sovraniteti ka kuptimin e përgjegjësisë si në planin e jashtëm ashtu edhe të brendshëm, që nënkupton respektimin e plotë të sovranitetit të ndërsjellë mes shteteve, ndërsa në kuptimin e brendshëm respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, në veçanti të minoritetit serb, duke theksuar me këtë rast se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e

miratuar këto ditë për Kosovën reflekton parimet e Planit të Ahtisarit në këtë çështje.

Zonja Tahiri po ashtu foli për synimet e Kosovës për përfaqësime diplomatike jashtë vendit dhe për krijimin e një arkitekture të sigurisë e të mbrojtjes në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n. Ajo vlerësoi rëndësinë e vendosjes së Misionit të BE-së në Kosovë dhe angazhimet me prioritet në vendosjen e sundimit të ligjit, zhbërjen e strukturave paralele serbe dhe luftën kundër korrupsionit.

Lidhur me vizionin ekonomik dhe programin zhvillimor të Qeverisë së Kosovës, në këtë takime ka folur këshilltari për ekonomi i Kryeministrit të Kosovës, Driton Qehaja.

Delegacioni i Republikës së Kosovës theksoi rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Irlandës dhe thellimin e bashkëpunimit në veçanti në sferën e ekonomisë. Duke marrë parasysh sukseset e mëdha të Irlandës për zhvillimin ekonomik të vendit, delegacioni kërkoi nga Irlanda mbështetje për Kosovën në veçanti në planin ekonomik, përfshirë këtu aspektet e ekspertizës dhe të investimeve, përfshirjen e Kosovës në programin e ndihmave zhvillimore të qeverisë Irlandeze, në edukim dhe punësim sezonale.



MBLEDHJA E GRUPIT JOFORMAL TË GRAVE DEPUTETE

Kryetare u zgjodh Flora Brovina

Sot, u mbajt mbledhja e Grupit Joformal të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës. Kryetare e Grupit Joformal të Grave Deputete u zgjodh deputetja Flora Brovina.

Në vijim u fol për funksionalizimin e këtij Grupi drejt fuqizimit të pozitës së gruas në shoqëri, sidomos

në aspektin organizativ.

U diskutua edhe për përgatitjet që duhet të bëhen lidhur me pjesëmarrjen sa më të denjë të dy përfaqësuesëve të këtij Grupi në Takimin e Paktit të Stabilitetit , në Kotorr të Malit të Zi, i cili do të mbahet më më 30 maj të këtij viti, ku do të diskutohet për temën e punësimit.



Kryetari i Shqipërisë, Bamir Topi dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi vënë kurora lulesh mbi varrezat e Jasharëve në Prekaz (Nga albumi i fotoreporterit tonë - 25.1.2008)